**VENDIM**
**Nr.332, datë 31.5.2006**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.437, DATË 9.9.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SHPALLJEN PROJEKT KOMBËTAR TË STUDIMIT RAJONAL TË ZHVILLIMIT TË HAPËSIRËS TIRANË-DURRËS", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 13 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.437, datë 9.9.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Listat nr.1 e nr.2 zëvendësohen me listat me të njëjtin numër, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Pika 5 shfuqizohet.

3. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"6. Drejtoria e Politikave të Planifikimit Urban, pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, bën bashkërendimin e punës, studimore e projektuese, të Institutit të Studimeve dhe Projektimeve të Urbanistikës dhe të institucioneve të tjera, të specializuara, të përmendura në listën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.".

4. Ngarkohet Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

LISTA NR.1

KOMISIONI SHTETËROR PËR PROJEKTIN KOMBËTAR

"Studimi rajonal i zhvillimit të hapësirës Tiranë-Durrës"

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1. Zëvendëskryeministri | Kryetar | | |
| 2. Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit | | Anëtar | |
| 3. Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit | | Anëtar | |
| 4. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës | | Anëtar | |
| 5. Ministri i Financave | | Anëtar | |
| 6. Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve | | Anëtar | |
| 7. Ministri i Brendshëm | | Anëtar | |
| 8. Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave | | | Anëtar |
| 9. Sekretari Shkencor i Akademisë së Shkencave | | Anëtar | |
| 10. Drejtori i Institutit të Statistikave | | | Anëtar |
| 11. Kryetari i Këshillit të Qarkut, Tiranë | | Anëtar | |
| 12. Kryetari i Këshillit të Qarkut, Durrës | | Anëtar | |
| 13. Drejtor i Politikave të Planifikimit Urban në Ministrinë e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit | | | Anëtar |

LISTA NR.2

INSTITUCIONET BASHKËPUNËTORE PËR HARTIMIN E PROJEKTIT KOMBËTAR
"STUDIMI RAJONAL I ZHVILLIMIT TË HAPËSIRËS TIRANË-DURRËS"

1. Instituti i Studimeve e Projektimeve Urbanistike
2. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve
3. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve
4. Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave
5. Instituti i Studimeve të Transporteve
6. Enti Kombëtar i Banesave
7. Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit
8. Sekretariati Teknik i Ujërave
9. Instituti i Studimit të Tokave
10. Drejtoritë e pyjeve dhe kullotave në qarqet Tiranë e Durrës
11. Zyra qendrore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe degët e tyre në Tiranë dhe Durrës
12. Drejtoritë e bujqësisë dhe ushqimit në qarqet Tiranë dhe Durrës
13. Instituti i Sizmikës
14. Instituti i Hidrometereologjisë
15. Qendra e Kërkimeve Gjeografike
16. Muzeu i Shkencave të Natyrës
17. Instituti i Monumenteve të Kulturës
18. Qendra e Kërkimeve Arkeologjike
19. Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës
20. Instituti i Statistikave
21. Këshilli i Qarkut Tiranë dhe Këshilli i Qarkut Durrës
22. Albtelekom sh.a.
23. Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
24. Ndërmarrja Hidrogjeologjike

Lista mbyllet me numër rendor 24